



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:168304

Datë: 02.07.2024

Numri i dokumentit: 05883290

P.nr.2023:168304

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Afrim Gashi, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.M nga fshati Opterushë, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 9 lidhur me par 6 dhe par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1053/2023 të datës 17.11.2023, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur **me datë 10.06.2024**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Qazim Kuqi, i akuzuari si dhe mbrojtësi – avokati R.H, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

SH.M, nga i ati M dhe e ëma Gj e vajzërisë B, i lindur me dt..... në fshatin Opterushë, komuna e Rahovecit, ka të kryer shkollën fillore, pensionist, i martuar, i ati i tre (3) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për ndonjë vepër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse

Më datë 05.08.2023 rreth orës 16:50 minuta, në fshatin bërnjakë, Komuna e Rahovecit, saktësisht përballë mobilerisë ‘V’, duke vepruar në kundërshtim me nenin 41 dhe 553 të ligjit nr.05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, rrezikon jetën e njerëzve dhe shkakton dëm të konsiderueshëm pasuror, në atë mënyrë që i pandehuri gjersa ishte duke drejtuar automjetin e tipit ‘D’, me targa, me ngjyrë të zezë, në magjistralen Xërxe -Rahovec, duke mos ia përshtatur shpejtësinë kushteve dhe rrethanave në rrugë, me të arritur në fshatin Bërnjakë, në rrugën ku ishte vijë e plotë pa të drejtë tejkalimi, dukshmëria e zvogëluar dhe duke mos siguruar mirë rrugën përpara në mënyrë të pa sigurtë hynë në tejkalim dhe me pjesën e përparme ballore të automjetit të tij e godet në pjesën e parë ballore të krahut të majtë automjetin e tipit ‘C’, me targa, të cilin e drejtonte i dëmtuari G.H, me ç’rast shkaktohen dëme të konsiderueshme

materiale në dy veturat, ndërsa lëndime të rënda trupore pësojnë të dëmtuarit G.H dhe Bekim Krasniqi, të përshkruara sipas ekspertizës mjeko ligjore të DR.V.K të datës 14.11.2023. kurse e ndjera A.M për shkak të lëndimeve ndërron jetë si rezultat i aksidentit, gjendje kjo e konstatuar në bazë të raportit të autopsisë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, punuar nga Dr.A.G, i datës 10.10.2023

- **Këso dore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 23 par.2, 38, 39, 40 par. 1 pika 1.2, 42, 69, 70, 71, 72 par 1.5 të KPRK-së, nenit 370 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarit:

I SHQIPTON

DËNIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve.
Koha e kaluar në paraburgim prej dt. 05.08.2023 deri më 30.08.2023 dhe arrest shtëpiak prej datës 30.08.2023 e deri me datën 05.11.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Pasi që gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve, **dhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 05.08.2023 deri më 30.08.2023 dhe arrest shtëpiak prej datës 30.08.2023 e deri me datën 05.11.2023, (tre muajve)**, i llogaritet në dënimin e shqiptuar, pjesa e mbetur prej nëntëdhjetë (90) ditëve, t'i zëvendsohet me dënim me gjobë në shumën prej njëmijedyqindë (1200) euro.

Gjykata, në mbështetje të nenit 44 të KPRK-së, i shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Të akuzuarit Sh.M, në shumën prej njëmijedyqindë (1200) Euro, ashtu që i akuzuari dënimin me gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 65 të KPRK-së, së bashku me dënimin kryesor i shqipton:

DËNIM PLOTËSUES

Të akuzuarit **Sh.M** merret leja e vozitjes e kategorisë “B” dhe i ndalohet marrja e lejes së re gjatë periudhës prej një (1) viti, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në shumë prej njëmijedyqind (1200) €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 43 të KPRK-së, atëherë të akuzuarit, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgimi në kohëzgjatje prej 60 (gjyshtëdhjet) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

Të dëmtuarit, G.S.H nga fshati Carallukë, Komuna e Malishevës dhe B.J.K nga fshati Janqishtë, Komuna e Malishevës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 (tridhjetë) Euro, në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumë prej njëzet (20) Euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej pesëdhjetë (50) Euro si dhe në emër të ekspertizës së komunikacionit shumë prej katërdhjetë (40) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

I. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.1053/2023 të datës 17.11.2023, kundër të akuzuarit Sh.M fshati Opterushë, komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.06.2024, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Qazim Kuqi, i akuzuari si dhe mbrojtësi – avokati R.H sipas autorizimit, ndërsa nuk kanë qenë prezent të dëmtuarit G.H dhe B.K, për të cilët gjykata ka prova se janë ftuar në kohë dhe në mënyrë të rregullt.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit i cila ka qëndruar në tërësi pranë saj. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën për të cilën akuzohet.

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, e ndien veten fajtor për këtë vepër penale për të cilën ngarkohet dhe se ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur dhe në këtë aksident i ka vdekur bashkëshortja A.M, është penduar për veprimin e bërë, dhe i premtoj gjykatës se një veprim i tillë nuk do të përsëritet.

Mbrojtësi i të akuzuarit – avokati R.H ka deklaruar se pasi që i mbrojturi I tijë ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetëshme dhe pasi që kjo aktakuzë është e mbështetur në provat që gjendet në shkresat e lëndës, dhe pasi që të mbrojturit tij ja ka shpjeguar shumë mirë dhe qartë se çka do të thotë pranimi i fajësisë dhe benifitet që i sjell pranimi i fajësisë, kur të shqiptohet dënimi i njëjti edhe njëherë ja ka ritheksuar se do ta bënë pranimin e fajësisë. Gjykatës i propozojë që kur të merr vendim për llojin dhe caktimin e dënimit të i mbrojturi I tijë, ti ketë parasysh vetëm rrethanat lehtësuese dhe atë se i njëjti është pensionist, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, dhe po ashtu në këtë aksident i njëjti është goditur aq rëndë sa që ndoshta edhe shqiptimi i dënimit më të ultë kishte me qenë i panevojshëm për shkak se të njëjtit në këtë aksident i ka vdekur bashkëshortja por pavarësisht nga vdekja e bashkëshortes të pandehurit të tijë i vjen keqe edhe për të dëmtuarit e tjerë G.H dhe B.K të cilët në këtë aksident kanë pësuar lëndime, e familja e të akuzuarit i kanë qar njerëz për ti kërkuar falje familjes së të dëmtuarve dhe të njëjtit janë deklaruar se kompenzimin e dëmit do ta realizojnë përmes kompanisë së sigurimit edhe ata janë të njoftuar se të akuzuarit Sh i ka vdekur bashkëshortja në këtë aksident dhe atyre ju ka ardhur keqe prandaj nga të gjitha këto gjykatës i propozoj që kur të merr vendim dhe llojin e lartësinë e dënimit të mbrojturit të tijë tia shqiptoj një dënim sa më të butë me arsyet që i ka cekur si më lartë.

Prokurori i shtetit jep mendimin lidhur me pranimin e fajësisë i cili ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë dhe pasi i ka kuptuar të drejtat, respektivisht favoret dhe pasojat e pranimit të

fajësisë, po ashtu duke marrë për bazë se aktakuza ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv të saj, ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale për të cilat ngarkohet i akuzuari. I propozoj gjykatës që i akuzuar të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë ligjor duke pasur parasysh shkallen e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën ngarkohet. Gjithashtu me rastin e vlerësimit dhe caktimit të dënimit të ketë parasysh edhe qëllimin e dënimit duke i vlerësuar rrethanat lehtësuese, pranimin e fajësisë në këtë shqyrtim gjyqësor, pendimin e tij, premtimin se ne te ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër penale, ndërsa si rrethana rëndësues pësha e veprës penale po ashtu edhe faktin se dy të dëmtuarit e tjerë në këtë aksident kanë pësuar lëndime të rënda.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 241 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPPRK-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzave.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari Sh.M, ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 370/9-6-1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale rrezikimi i trafikut publike kryen: **“Nëse vepra penale nga paragrafi 9. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet,”**. Lidhur me paragrafin 6: **“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.”**. Lidhur me paragrafin 1: **“Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.”**

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin Sh.M ka shpallur fajtor sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që edhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 ,70,71 dhe 72 par.1.5 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuari: se është i gjendjes së dobët ekonomike, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, si dhe kufijtë e zbutjes së dënimit pasi që në këtë aksident i pandehuri ka humbur edhe bashkëshorten, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese janë se dy të dëmtuar kanë pësuar lëndime të rënda trupore. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin i shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, dhe këto dënime si i tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurë të rregullt juridiko civile bazohet në nenin 462 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 452 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nen paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L – 109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.2023:168304, me datë 10.06.2024

B. Profesional
Afrim Gashi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.